



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:255764  
Datë: 15.12.2023  
Numri i dokumentit: 05071979

**C-IV.-14-6146**

*Ankuesi:*

S A nga Prishtina.

**Kundër**

*E paditura:*

**N.SH “Gërmia”**, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, , Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.08 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PRN093-0071 i dt.08 shtator 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- 2. Nuk caktohen** taksa gjyqësore për ankuesin.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.16 shtator 2014, ankuesja parashtrroi ankesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. PRN093-0071 i dt.08 shtator 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale ndaj N.SH “Gërmia” ( në Likuidim). Ankuesja pohoi se atakon vendimin e AL-së për shkak se ankuesja nuk ka vendim për periudhën për të cilën kërkohet se ka qenë në asistencë sociale. Ka kërkuar që ankesa e saj të aprovohet si e bazuar. Së bashku me ankesën ai ka bashkëngjitur kopjen e vendimit të AL, Vendimin nr.901 dt.05.02.2003, Formularin e kërkesës për likuidim, Kërkesën e AKP nr.10079 dt.21.08.2014, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Me dt.18 tetor 2023 e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar ndaj ankesës, pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se kërkesa e parashtruesit është refuzuar duke u bazuar në faktet dhe bazat ligjore të nenit 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Më tutje e paditura thekson se ankesa e parashtruesit është e pa pranueshme. Pala kundërshtarë konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Në fund të përgjigjes së saj AKP thekon ankesa duhet refuzuar si e pa pranueshme dhe e pa bazuar dhe kërkon që të vërtetohet vendimi i AL-së në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr. 06/L-086.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësar apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesja ka qenë punëtore e NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vjen në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh asistencën sociale. Pra, ankuesja nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me periudhën dhe llogaritjen e asistencës sociale të pa paguar ashtu që ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së saj në tërësi.

Vendimi i Autoritetit të Likuidimit si dhe Vendimi i dorëzuar nga ankuesja nuk mund të shërbejnë si prova të vetme për ti njohur të drejtën e pretenduar në ankesë. Andaj, këto prova nuk vërtetuan në tërësi kërkesën e saj. Poashtu, ankuesja dorëzoi Vendimin nr.901 dt.05.02.2003 me të cilat vërtetohet se është përfituese e ndihmës sociale mirëpo, ky vendim është vetëm për një periudhë të caktuar kohore 3 mujore. Ndër të tjera ankuesja dorëzoi edhe kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, formularin e kërkesës së dorëzuar në AKP dhe kërkesën e AKP drejtuar ankueses me të cilën kishte kërkuar prova shtesë nga e njëjta. Pra, Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensimin e mjeteve të asistencës sociale, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla ankesa e ankueses është refuzuar si e pabazuar.

Andaj në bazë të lartë cekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesja e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e  
**Hajrie Shala**